

VENDIM
Nr. 289, datë 24.4.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 534, DATË 22.9.2021,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘NDËRTIM RRUGA PORTO-
ROMANO–DURRËS, LOTI 3’”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 534, datë 22.9.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikat 3 dhe 4, vlera “... 30 349 958 (tridhjetë milionë e treqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë ...” zëvendësohet me “... 30 646 898 (tridhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë ...”;

b) Në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

i. Pas numrit rendor 71 shtohet numri rendor 72, sipas të dhënave të tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii. Shuma totale 30 349 958 zëvendësohet me shumën totale 30 646 898.

2. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës–Kavajë–Krujë dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Nr.	PRONARI			Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Sip. totale	Lloji pasurisë	Sipërfaqe shpronësimi	Çmimi lekë/(m ²)	Vlera (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
72	Rrahim	Hamit	Bardhoci	8517	38/27	5650	are	707	420	296,940	Konfirmuar nga ASHK-ja